Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                     | <i>2</i>  | <i>3</i>      | <i>4</i>     | <i>6</i>               |   |  |
|------------------------------|---|---------------|--------------|------------------------|---|--|
| <b>Artikulli</b>             | <b>Përshkrimi i shërbimit</b>   | <b>Njesia</b> | <b>Sasia</b> | <b>Çmimi për njësi</b> | <b>Çmimi total për shërbim (3 x 4X)</b> |  |
| <b>1</b>                     | <b>Hosting dhe migrimi i programeve ne versionin pasardhes Cloud</b>                        |               |              |                        |   |  |
| 1.1                          | - Oracle Financials (10 Users)  | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Oracle Inventory Management (10 Users)  | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Oracle Enterprise Asset Management (10 Users)   | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Oracle Purchasing (5 Users)   | Set           | 1            |                        |   |  |
| 1.2                          | <b>Sherbimi i zbatimi te shërbimit te Migrimit ne Cloud te Licensave mesiper, perfshire</b> | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Setup te sistemit;  | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Migrimin dhe hapjen e te dhenave ne sistemin e ri;  | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Trajninin e personelit teknik per sistemin e ri;  | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Pershtatjen dhe permiresimin e raporteve;   | Set           | 1            |                        |   |  |
|                              | - Mbeshtetje ne vend pergjate periudhes fillestare 1 mujore;                                | Set           | 1            |                        |   |  |
| <b>2</b>                     | <b>Mirembajtja e licensave dhe shërbimeve ekzistuese</b>                                    |               |              |                        |   |  |
|                              | - Oracle Human Resources, Self-Service HR (500 Employee)                                    | Vite          | 1            |                        |   |  |
|                              | - @Paga (10 Users)  | Vite          | 1            |                        |   |  |
|                              | - Arkives dhe te protokollit (workflow)   | Vite          | 1            |                        |   |  |
|                              | - Sherbimi i fiskalizimit te fatures elektronike  | Vite          | 1            |                        |   |  |
| <b>3</b>                     | <b>Sherbime te lidhura me sistemet</b>  |               |              |                        |   |  |
| 3.1                          | Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshtje teknike dhe operacionale ne vend           | Vite          | 1            |                        |   |  |
| <b>Çmimi total (Mallrat)</b> |   |               |              |                        | _____                                   |  |

---

|   |  |
|---|--|
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |  |
| <b>TVSH (%)</b>                           |  |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |  |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |



---

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

## Shtojca 4

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

---

## Shtojca 5

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimi që kërkohet:**

Sipas termave të referencës Shtojca 7.

**Afatet e ekzekutimit:**

|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
|  | Rinovimi i suportit dhe licensave te platformes elektronike financiare, burimeve njerezore, arshives elektronike dhe sistemit te menaxhimit te dokumenteve, Fiskalizimit dhe Fatures elektronike Online dhe Migrimi ne versionin cloud |  |  | <i>Sipas termave të referencës Shtojca 7</i> |
|--|--|--|--|--|

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### 1. Qëllimi i këtij shërbimi, është

- **Perditesimi dhe kalimi ne versionin cloud te Sistemit të administrimit Financiar, Logjistikes,** aktualisht i hostuar në mjediset e Operatorit te Sistemi te Transmetimit (ketu e ne vijim OST), por qe eshte jashte termave te suportit te prodhuesit Oracle. Ky sistem mundeson operimin, ndjekjen e operacioneve te brendshme qe lidhen me administrimin e burimeve financiare, logjistike dhe shoqerise. Ne perputhje me percaktimet e prodhuesit Oracle, kerkohet qe sistemi te perditesohet ne versionin pasardhes ne ERP Cloud te hostuar ne serverat cloud te Oracle.
- **Mirembajtja e Sistemit te administrimit Financiar, Inventareve, Arkives si dhe Burimeve Njerezore.** Vec sistemeve te mesiperme, qe mendohet pas zbatimi te migrohen ne sistemin cloud, mbeshtetje teknike do te ofrohet edhe mbi sistemet Arkives, Burimeve Njerezore dhe Payroll e hostuar në mjediset e Operatorit te Sistemi te Transmetimit (ketu e ne vijim OST). Keto sisteme mundesojne operimin, ndjekjen e operacioneve te brendshme qe lidhen me dokumentacionin si dhe administrimin e burimeve njerezore te shoqerise.
- **Fiskalizimi online i faturave te gjeneruara nga Sistemi.**Sistemi i fiskalizimit duhet te mundesoje kalimin automatik te faturave te leshuara ne sistemin e administrimit financiar,perdorues te finances si dhe perdorues per hedhjen manual te faturave te shitjes (deri ne lidhjen e automatike te sistemit); Sistemi/Moduli i modelit workflow per aprovimin e faturave te blerjes.
- **Trajnimi i personelit te OST.** Krahas sherbimeve te mesiperme, sherbimi kerkohet te perfshije edhe ceshtje te rendesishme qe lidhen me trajnimin e vazhdueshem te personelit te OST.

#### 1.2. Situata Aktuale dhe nevoja per migrimin e sistemit financiar;

Sistemi i Administrimit Financiar Oracle E-Business Suite eshte implementuar ne OST ne vitin 2013 dhe me pas ne sistem jane realizuar perditesime qe kane te bejne me security patches apo patch te tjera te sistemit te rekomanduar nga prodhuesit per mbeshtetjen e suport. Aktualisht sistemi eshte ne versionin R 12.1.3 dhe mbeshtetet ne infrastrukturen :

- Oracle Database 11g
- Oracle Applications 12.1.3
- Sistemi operativ Linux RedHat Enterprise

Referuar percaktimeve te prodhuesit Oracle, si versioni i database ashtu dhe ai i aplikimit , kane kaluar ne mbeshtetje teknike te kufizuar dhe me pagese, duke mos patur me akses ne patch te rinj, rregullime te ndryshme apo perditesime. Kjo e vendos aplikimin ne rrezik te larte per shkeputje dhe performance te ulet, rrisqe sigurie etj,duke cuar ne rritje te kostove. Per keto arsye kerkohet te realizohet migrimi i sitemit ne versionin Cloud ERP.

Ky version vec perditesimi te teknologjise dhe te komponenteve kryesore, permбан avantazhet e meposhtme:

- (1) Ofrim i funksionaliteteve te reja
- (2) Permiresim i performances

- 
- (3) Ka nje shkalle te larte sigurie, pasi ai mbrohet nga Oracle
  - (4) Mbrojtje te te dhenave
  - (5) Backup dhe restore
  - (6) Migrimi ne versionet e reja te sistemit cdo 90 dite
  - (7) Oracle Analytics me analiza dhe dashboards
  - (8) Ulje te kosos se pronesisë

## **OBJEKTI I SHËRBIMIT**

---

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është **Mirembajtja dhe perditesimi i sistemeve te mesiperme te informacionit**, ne cdo komponent te tij, me qellim sigurimin e vazhdimesise se punes ne te gjithë komponentet dhe sherbimet e ofruara nga ky sistem. Komponentet kryesore të Sistemit, të cilët janë edhe objekt direkt i këtij shërbimi janë:

- i. Sisteme te pergjitheshme: Sistemi i adminsitrimit te workflow (DMS) dhe te arkives.
- ii. Software Financiar: Finance, Asete, Logjistikes, Mirembajtjes se Mjeteve, Raportimit te Integruar Financiar;
- iii. Sistemin e Administrimit te Burimeve Njerezore dhe te Pagave.
- iv. Fiskalizimi i faturave, si dhe administrimi i faturave elektronike ne perputhje me ndryshimet ligjore qe kane hyre ne fuqi ne Janar 2021.

Ndersa sistemet te cilat kerkohet te migrohen ne versionin e fundit Oracle Cloud ERP jane ato qe lidhen me administrimin financiar te OST. Me konkretisht modulet per migrim dhe me pas per mirembajtje jane : Financiar dhe Kontabilitet; Inventare; Asete si dhe Urdher Blerjet. Ne kete proces, migrimit ne cloud ERP, ofertuesit ekonomik duhet te realizojne:

- Analiza e gjendje aktuale te sistemeve te administrimit Financiar dhe te Inventareve Oracle EBS; si dhe raportimi ne baze te kesaj analize te nje dokumenti per ndryshimet perkatese (versioni i ri krahasuar me ate aktual) si dhe nje dokumenti te dyte qe lidhet me migrimin si dhe hapat ne kete process.
- Hartimi i nje dokumenti përshkrues të sistemit.
- Migrimi i te dhenave te nevojeshme per operimin e sistemit te ri Cloud ERP.
- Implementimi i migrimit te sistemit.
- Trajnimet për të gjithë stafin që do të përdori këtë sistem (të ndara për përdoruesit e sistemit dhe administratoreve të sistemit)

Sistemet e mesiperme te informacionit jane plotesisht te integruara me njera tjetren dhe standardizojne dhe automatizojne nje pjese te madhe te procedurave te punes te ketij institucioni, duke u dhene te gjithë perdoruesve te bejne menaxhimin e punes se tyre ne mirembajtjen e te dhenave financiare, mirembajtjen ne menyre elektronike te dokumentacionit te kompanise, mirembajtjen dhe menaxhimin e plote te burimeve logjistike dhe atyre njerezore.

Plaftforma baze, mbi te cilen jane ndertuar keto sisteme eshte OracleMe qellim mireoperimin e vazhdueshem te sistemit si dhe perditesimin e tij ne vazhdimesi, ne perputhje me ndryshimet e pergjitheshme te tregun boteror ne kete fushe si dhe perditesimet e vazhdueshme te Oracle, OST ka domosdoshmeri perditesimin ne vazhdimesi te sistemeve qe aktualisht ka, veprim ky qe sjell si permiresim te metejshem gjate proceseve ditore, por edhe duke eliminuar problemet e perdoruesve, te cilat do te shtoheshin me kalimin e kohes.

Te gjitha sistemet e permendura jane kritike per OST dhe mbi te gjitha jane ne kohe reale, pra pjesa me e madhe e informacionit qe ka te beje me fushen financiare, menaxhimin elektronik te

---

dokumentave, menaxhimin e burimeve logjistike dhe burimeve njerezore ruhet ne kohe reale dhe ky informacion eshte i kerkueshem nga baza e te dhenave sipas kerkesave te niveleve te ndryshme ne hierarkine e kompanise. Per kete arsye mirembajtja e gjithë ketyre sistemeve eshte e domosdoshme per te pasur nje pasqyre te plote ecurise si dhe planifikimit te veprimtarise te OST.

Vec supportit te mesiperm, ne kuadrin e ndryshimeve ligjore ne fuqi per fiskalizimit si dhe faturen elektronike, kerkohe nga operatori ekonomik realizimi i ndryshimeve te nevojeshme ne sistem ERP si dhe integrimi ne kohe reale me sistemet e fiskalizimit. Ky integrim duhet te konsistoje ne ndertimin e procese për menaxhimin e faturave elektronike, si dhe raportimin e tyre ne kohe reale sikurse percaktuar ne legjislacionin tatimor qe lidhet me faturen elektronike. Ne kete drejtim, kerkohe qe Operatori Ekonomik te realizoje:

- Lidhjen autormatike te sistemit aktuale Oracle EBS si dhe atij te ri Oracle ERP Cloud pas kalimit te operimit;
- Krijimi i kanalit te komunikimeve midis portalit online dhe sistemit të qarkullimit të dokumentacionit në strukturat e brendshme të OST sh.a.
- Trajnimet për të gjithë stafin që do të përdori këtë sistem (të ndara për përdoruesit e sistemit dhe administratoret të sistemit)

---

## SUPOZIMET DHE RISQET

---

### 3.1 Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti do të bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti
- Bashkëpunimi midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit
- Vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e projektit
- Alokimi i burimeve njerezore të nevojshëm për implementimin e këtij projekti
- Përcaktimi i saktë i buxhetit të nevojshëm për realizimin me sukses të projektit

### 3.2 Risqet

Është i rëndesishëm impenjimi i plotë i grupeve të punës pjesëmarrëse (nga të dyja palët) në zhvillimin e projektit. Disa nga faktorët që do të mund të riskonin ecurinë e projektit:

- Ndërprerja e pjesshme apo e plote e operimit financiar te OST
- Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve kyç dhe grupeve të interest mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të projektit
- Vlerësimi jo i saktë i situates aktuale të sistemit dhe infrastrukturës
- Mospërcaktimi i saktë i burimeve të nevojshëm për realizimin e projektit
- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e moskoordinimit të punës mes pjesëtarëve të përfshirë në këtë proces
- Mungesa e bashkëpunimit me palët e treat për vënien në dispozicion të të dhënave dhe web service-ve përkatëse.
- Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik në të tilla projekte.

---

## MBULIMI TEKNIK I SHËRBIMIT

---

Ky sherbim duhet te perfshije (ne perputhje me keto Terma Reference) ne menyre te domosdoshme:

- Mirembajtjen e programeve baze;
- Konsulence per optimizimin e konfigurimit te pajisjeve, ku eshte instaluar sistemi;
- Zhvillim dhe shtime funksionalitetesh sipas kerkeses; ne menyre kryesore zbatimi i sistemit te fiskalizimit online si dhe lidhja me sistemin e brendshem ERP Oracle EBS.
- Upgrade te sistemeve te administrimit financiar;
- Hostimi i komponenteve te sistemit financiar ne cloud te prodhuesit te sistemit Financiar;
- Perditesimin falas te sistemeve nepermjet patches, ne varesi te nevojave te OST si dhe te evolimit ne kete fushe, nga vete prodhuesit e programeve aplikative;
- Trajnimin e personelit per sistemet
- Konsulence, Trajnimin ne vend te personelit; sipas percaktimeve ne kete dokument.

### KOMPONENTET KRYESORE TE SISTEMIT

Sistemet e mesiperme u krijojne mundesi perdoruesve te regjistrojne te gjitha aktivitetet e tyre periodike (ditore, javore, mujore etj) te te gjitha veprimeve qe kane te bejne me aktivitetin financiar te kompanise, menaxhimin elektronik te te gjitha dokumentave te protokollit, administrimin planifikimin si dhe ndjekjen e inventareve, aktiveve te qendrueshme si dhe burimeve njerezore.

Perdoruesit direkt ne sistem, jane personeli teknik dhe operacional; ndersa perdorues indirekt jane personeli i larte administrimi i OST te cilet nepermjet moduleve te ndryshme ne projekt, integrimin te shumefishte midis tyre si dhe sistemit te qenderzuar te raportimit financiar dhe operacional realizojne vendimmarrjen (aprovim apo refuzim te operacioneve) dhe marrin ne kohe reale rezultatet aktuale si dhe krahasimin e veprimtarive te ndryshme perkundrejte objektivave. Nepermjet ketij informacioni, te marre ne kohe reale personeli i OST, nepermjet sistemit, merr gjithashtu nje vleresim/tendence te pritshtme te treguesve.

#### 5.1 Modulet kryesore ne sistem

Modulet kryesore, perberese te sistemeve jane si meposhte:

| Nr | Pershkrimi   | Licensat  | Sasia    | Prodhuesi |
|----|--|---|----------|-----------|
| 1  | Sistemi Financiar, Moduli: Librit i Madh                                   | Oracle Busines Suite Financials (General Ledger)      | 10 Users | Oracle    |
| 2  | Sistemi Financiar, Moduli: Te Pagueshmet                                   | Oracle Busines Suite Financials (Account Payables)    | 10 Users | Oracle    |
| 3  | Sistemi Financiar, Moduli: Te Arketueshmet                                 | Oracle Busines Suite Financials (Account Receivables) | 10 Users | Oracle    |
| 4  | Sistemi Financiar, Moduli: Menaxhimi i Arkes dhe i Bankes                  | Oracle Busines Suite Financial (Cash Management)      | 10 Users | Oracle    |
| 5  | Sistemi Financiar, Moduli: Blerjet   | Oracle Busines Suite Purchasing                       | 5 Users  | Oracle    |
| 6  | Sistemi i Menaxhimit te Logjistikes, Moduli i Administrimit te Inventareve | Oracle Busines Suite Inventory Management             | 10 Users | Oracle    |
| 7  | Sistemi Financiar, Moduli: Asetet Fikse                                    | Oracle Busines Suite Financials (Asset Mangement)     | 10 Users | Oracle    |



|    |   |   |  |                  |
|----|---|---|--|------------------|
| 8  | Sistemi Financiar, Moduli: Pagave   | @Paga   | 5 Users                                | @Paga – ARKIT    |
| 9  | Sistemi i Protokollit ,<br>Sistemi i Arkives, Moduli i skanimit si dhe i vete arkives                                 | Newgen OmniDocs<br>Newgen OmniScan,<br>@Bpm       | 10 Conc.                               | NewGen<br>NewGen |
| 10 | Sistemi i Menaxhimit te Dokumenteve   | @Bpm  | 1 Set<br>(Unspecified number of users) | Oracle           |
| 11 | Sistemi i Burimeve Njerezore, Moduli i Administrimit te Burimeve Njerezore  | Oracle Business Suite, Human Resources Management | 500 Employees                          | Oracle           |
| 12 | Sistemi i fiskalizimit online dhe fatures elektronike, perfshire edhe pershtatjen me sistemit Oracle per kete lidhje. | Sherbim   | 15 Perdorues                           |                  |
| 13 | Ndertimi i workflow per miratimin e faturave ne blerje.   | Sherbim.  | 30 Perdorues                           |                  |

## 5.2 Funkcionet dhe lidhjet kryesore midis sistemeve

Me poshte pershkruhen funksionet kryesore modulet kryesore si dhe burimet e informacionit dhe lidhjet midis moduleve ne sistem:

- Te gjitha keto sisteme ruajne informacion te centralizuar per te gjitha pikat e OST. Sistemi eshte teresisht online dhe cdo informacion i hedhur nga secila prej zyrave satelitare te OST ruhen direkt ne bazen e te dhenave dhe informacioni eshte i aksesueshem ne kohe reale nga te gjithe perdoruesit qe kane te drejte te aksesojne nje nga keto sisteme.
- Moduli i Librit te Madh ne sistemin Financiar eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithe veprimet financiare, si ditaret e ndryshme, disa veprime bankare dhe rivleresimi. Secili prej perdoruesve shikon vetem veprimet brenda njesise se tij operative, por perdorues me te drejta te tjera ne zyra qendrore kane te drejte te shikojne te dhenat e te gjithe kompanise. Te gjitha njesite organizative te brendshme te OST jane te organizuara ne sistem si qendra te vecanta te kostos, duke garantuar 1) ndarjen e raportimit dhe pergjegjesive midis njesive, dhe njekohesisht 2) raportimin e konsoliduar ne baze insitucioni (ku te gjitha rezultatet e njesive pasqyrohen ne pasqyrat permbledhese per institucionin). Ky eshte moduli kryesor ne sistem, dhe realizon lidhjen me thuaj te gjithe modulet e tjera ne sistem.
- Moduli Te Pagueshmet ne sistemin Financiar eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithe veprimet qe kane te bejne me furnitoret si faturimet, pagesat, parapagesa etj. Secili prej perdoruesve shikon vetem veprimet brenda njesise se tij operative, por perdorues me te drejta te tjera ne zyra qendrore kane te drejte te shikojne te dhenat e te gjithe kompanise. Moduli eshte i integruar minimalisht me ate te Librit te Madh, Arkes/Bankes, Administrimin e Inventareve, Blerjeve si dhe Administrimit te Aktiveve te Qendrushme.

- 
- Moduli Te Arketueshmet ne sistemin Financiar eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithë veprimet qe kane te bejne me klientet si faturimet, arketimet, para-arketimet etj. Secili prej perdoruesve shikon vetem veprimet brenda njesise se tij operative, por perdorues me te drejta te tjera ne zyra qendrore kane te drejte te shikojne te dhenat e te gjithë kompanise. Moduli eshte i integruar minimalisht me ate te Librit te Madh, Arkes/Bankes.
  - Moduli i Menaxhimit te Arkes dhe Bankes ne sistemin Financiar eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithë veprimet qe kane te bejne me llogarite bankare si pagesa, arketime, parapagesa etj. Secili prej perdoruesve shikon vetem veprimet brenda njesise se tij operative, por perdorues me te drejta te tjera ne zyra qendrore kane te drejte te shikojne te dhenat e te gjithë kompanise. Moduli realizon gjithashtu veprimet qe lidhen me rivleresimet, konvertimet si dhe raportimin ne kohe reale ne Librin e Madh, Librit te Blerjeve si dhe Librit te Shitjeve.
  - Moduli i Blerjeve, eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithë veprimet qe kane te bejne me blerjet si furnitoret, artikujt, urdhrat e blerjes etj. Sistemi eshte i konfiguruar ne menyre te tille qe te mundesoje planifikimin e blerjeve, realizimin e blerjeve te perqendruara si dhe blerjeve te decentralizuara ne rastet kur njesite realizojne blerje/prokurime per qellime te brendshme. Moduli eshte i integruara me Modulet e Administrimit te Inventareve dhe te Aktiveve te Qendrueshme.
  - Moduli i Pagave ne sistemin Financiar eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithë veprimet qe kane te bejne me pagesat e punonjesve te OST si paga, dieta, tatime etj. Mbas kontrollit dhe te miratimit te pasqyrave per secilen nga njesite, sistemi me pas mundeson gjenerimin e pasqyrave (sipas njesive dhe te konsoliduara) sipas kerkesave te legjislacionit vendas si dhe kerkesave te administrimit te brendshem. Perdoruesit ne sistem lejohet te konsultojne dhe te operojne vetem brenda njesise qe u perkasin ndersa administrate qendrore ka nje pamje te pergjitheshme analitike dhe te konsoliduar te treguesve kryesore financiar dhe administrative. Moduli eshte plotesisht i integruar me Modulet e Administrimit te Burimeve Njerezore, Librit te Madh si dhe te Administrimit te Aktiveve te Qendrueshme.
  - Moduli i Aktiveve te Qendrueshme (Aseteve Fikse) ne sistemin Financiar eshte nje modul ne te cilin regjistrohen te gjithë veprimet qe kane te bejne me asetet e OST si regjistrimi, amortizimi, terheqja, transferimi etj. Secili prej perdoruesve ne sistem administron aktivet respektive te njesise dhe raportin ne menyre periodike mujore aktivitetin ne Librin e Madh. Moduli eshte ndertuara per te realizuar nevojën qe lidhen me amortizimin si dhe perlllogaritjen e dyfishta te vleres (dhe amortizimit) te aktiveve qe lidhen me ndertimin e pasqyrave te amortizimit fiskal si dhe atij manaxherial. Moduli eshte i ndertuar ne menyre te tille qe te realizoje transferimet e aktiveve midis qendrave te kostove, kontabilizimin dhe ndjekjen e llogarive te aktiveve/projekteve ne proces si dhe per te trajtuar kontabilizimin automatik ne Librin e Madh te te gjithë veprimeve mbi aktivet.
  - Sistemi i Arkives eshte nje sistem ne te cilin regjistrohen te gjithë dokumentat ne menyre elektronike per ti pasur te indeksuara dhe te kerkueshem nga te gjithë punonjesit e OST. Sistemi eshte i pajisur me nje modul automatic skanimi dhe indektimi te materialeve dhe aktualisht ka gjetur perdorim ne njesine e arkiven, protokollit si dhe te arkives teknike. Secili prej perdoruesve eshte i kufizuar per te drejtat, nivelin e aksesist dhe te operationeve qe mundet te kryeje ne arkiven elektronike. Gjithashtu sistemi eshte i pajisur me nje modul te menaxhimit te rrjedhes se punes se dokumentacionit shkresor, i cili menaxhon te gjithë procesin e miratimit te shkresave dalese dhe te brendshme si dhe procesin e veprimeve qe duhen ndermarre ne mberritjen e shkresave hyrese.

- Sistemi i Burimeve Logjistike eshte nje sistem ne te cilin regjistrohen te gjitha veprimet qe kane te bejne me menaxhimin e logjistikës si artikujt, hyrjet, daljet, veprimt e ndryshme etj. Secila nga njesite ndjek ne menyre te pavarur operacionet qe lidhen me njesine ndersa sistemi eshte i ndertuar ne menyre te tille qe te zgjidhje problematiken qe lidhet me transferimin e inventareve midis njesive organizative si dhe raportimin automatik te rezultatit te veprimeve ne Librin e Madh. Moduli eshte plotesisht i integruar me modulet e Librit te Madh ate te Blerjeve.
- Sistemi i Burimeve Njerezore realizon dhe mbeshitet aktivitetet e OST e qe lidhen me (1) punesimin me kohe te plote si dhe atij me kohe te pjesshme, (2) percaktimin fillestar si dhe ndryshimet e nevojeshme te struktures organizative, (3) mirembajtjen dhe ndjekjen e te dhenave te punonjesve, (4) planifikimin dhe ndjekjen e te dhenave qe lidhen me zhvillimet e karrieres dhe kualifikimin profesional te punonjesve; (5) administrimin dhe ndjekjen e presences ne detyre; (6) ndjekjes se lejeve vjetore; (7) ndjekjes se sherbimeve te punonjesve. Moduli eshte i hapur, per te gjitha punonjesit, ne menyre qe ata te informohet mbi te dhenat personale, zhvillimit te profesional si dhe te karrieres qe mbahen ne regjistrat e OST. Ne menyre te vecante, te dhenat mbi punonjesit, jane te aksesueshme nga eproret e punonjesve. Moduli eshte plotesisht i integruar me modulin e pagave, modulet e Bankes dhe Arkes, te librit te madh, aktiveve te qendrueshme si dhe realizon ne menyre automatike ndryshimet dhe percaktimet e te drejtave te punonjesve ne sistem.
- Moduli i Raportimit eshte nje nje modulet kryesore ne sistem. Ai mbledh, analizon dhe paraqet informacione nga te gjitha modulet ne sistem. Ne menyre te vecante moduli realizon (1) raportimin e pergjithshem dhe te integruar te te gjitha informacionit financiar si dhe te treguesve te performances apo te planifikimit te OST; (2) Integrim te te gjitha informacioneve qe mbahen ne modulet e sistemit; (3) raportimin kohor, te agreguar dhe analitik te ecurise financiare dhe te treguesve te pergjithshem te performances se OST; (4) Integrim te te gjitha informacioneve qe mbahen ne modulet e sistemeve te tjera te OST sh.a.. Moduli eshte dinamik, dhe lejon personelin e OST te kryej shtimin e raporteve dhe analizave te reja. Gjithashtu moduli i raportimit permban nje atribut te thjeshtuar (user-friendly) qe mundeson krijimin, editimin dhe caktimin e privilegieve per user-at ekzistues dhe ato te rinj. Cdo raport, analize e re eshte e disponueshme per te gjitha punonjesit e OST, por secili mund te personalizojë raportet sipas kerkesave te tij ne ambjentin personal te punes qe mund ta shikojë vetem ai.

### 5.3 Funkcionet e sistemit te fiskalizimit, fatures elektronike si dhe workflow te miratimit te faturave te blerjes.

- Programit kerkohej te jete plotesisht web, si sigurte dhe i perdorshem ne cloud pa nevojë instalimi ne kliente apo ne server. Aplikacioni aksesohet nëpërmjet ndërfaqes web nëpërmjet një browseri.
- Kanali i lidhjes midis browser-it dhe serverit eshte i kriptuar me TSL/SSL nëpërmjet protokollit HTTPS.
- Sistemi ofron te gjitha funksionalitetet, te ofruara ne desktop edhe ne aparate mobile.
- Bazat e të dhënave e tipit RDBMS, jane të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi.
- Serveri i programit eshte i ndarë nga baza e të dhënave.
- Kontrolli kryhet statusin e cdo NIPT-i para se te leshohet fatura.
- Sistemi duhet te mundesojë lidhjen automatike me sistemin Oracle ERP si dhe hedhjen manuale te faturave.

- 
- Hedhja e veprimeve (faturave) ne sistemit behet sipas parimit te kontrolli te kater syve. Per kete, sistemi duhet te mundesoje ndarjen e profileve mids hedhesit te veprimeve si dhe aprovuesit.
  - Sistemi duhet te realizon edhe ndarjen e te drejtave te perdoruesve sipas qendrave te kostove. Cdo perdoruesi i caktuar ne nje qender kosto duhet te shoh vetem veprimet qe lidhen me qenderen perkatese te kostot. Sistemi kerkohet gjithashtu te mundesoje edhe shtimin e hallkave shtese (si ai i kontabilitetit qe ben aprovimin final perpara deklarimit prane tatimeve) nese do te kerkohen ne vazhdim.
  - Sisemi te mundesoje njoftimin ne kohe te caktuar per cdo fature te re blerjeje te raportuar nga shitesit prane sistemi te tatimeve. Vec njoftimit, per perdoruesit e loguar ne sistem, ai duhet te mundesoje kontrollin ne kohe reale te faturave te blerjes se raportuara prane serverit te tatimeve.
  - Sistemi te mundesoje raportimin ne kohe reale te gjendjes se faturave te shitjes, ne lidhje direkte nga DPT.
  - Miratimi i faturave te blerjeve duhet te realizohet nepermjet kalimit te disa hapave te brendshem organizativ. Perdoruesit e sistemit, duhet te jene te ndare ne role:
    - Marrjes dhe shperndarjes brenda organizates se faturave te blerjes;
    - Kontrolli i pare; i cili eshte personi qe ndjek praktiken e blerjeve perkatese prane OST; i cili kryhen pranimin apo refuzimin e fatures;
    - Kontrolli i dyte/ apo Konfirmuesi i cili pranon ose refuzon veprimin e kontrollit te pare;
    - Aprovuesi, i cili realizon aprovimin apo refuzimin e fatures prane sistemi i tatimeve; Fatura shkon prane Aprovuesit (qe pergjithesisht eshte personi i finances) vetem pasi ka kaluar me pare kontrollin dhe konfirmin.
    - Funksionalitetet e sistemit duhet te arrihen me parametrizime dhe konfigurime. Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo databazë.
  - Në çdo modul dhe çdo formë të tij, aplikacioni duhet te mundesoje export masiv të dhënash në bazë dokumentash excel ose csv.
  - Sistemi duhet te ofroje nderfaqe automatike per shkembimin e te dhenave te faturave si dhe dokumenta te tjere te nevojshem per fiskalizimin sic mundet te jene fatura per kliente te pergjithshem ose dokumenta shoqerues.
  - Sistemi duhet te paraqese informacion per faturat e derguara sipas statusit te derguar me sukses apo jo.
  - Hyrja ne program duhet te sigurohet nepemjet dhenies se kredencialeve te perdoruesit dhe fjalekalimit;
  - Sistemi duhet te ofroje ofron shkembimin automatike te te dhenave qe lidhen me faturat per biznese, qeveri si dhe kliente fundore te paidentifikuar. Gjithashtu, ai duhet te lejoje fiskalizimin e doumentave shoqerues.
  - Sistemi duhet te integrohet me sistemin financiar/ ORACLE ne menyre integrale dhe ne kohe reale per te shmangur hedhjen e dyfishte te veprimeve. Kjo lidhje duhet te konsistoje ne :
    - o Shkembimin e faturave ne dalje;
    - o Konfirmin e raportimit prane tatimeve;

- 
- Shkembimin e faturave shoqeruese te leshuara nga sistemi ERP;
  - Rakordimin e faturave ne blerje midis ERP dhe e-Fatures;
  - Shkembimin e konfirmeve te leshuara ne sistemin e e-Fatures si dhe te Tatimeve;

Per kete, Sistemi duhet te suportoje per kete nderfaqe te hapur komunikimi dhe e afte te ofroje konvertimet e nevojeshme te modelit e kerkuar nga tatimet (UBL 2.1) me ate te sistemit te brendshem Oracle. Cdo komunikim duhet te logohet.

- Sistemi nuk duhet të lejojë fshirje rekordesh.
- Sistemi duhet të kaloje të gjithë dokumentet në arkiven dixhitale të OST; Dokumentet duhet të kalojnë të shoqëruar me metadatat e regjistruara në sistemin e rrjedhës së dokumentacionit shkresor.
- Sistemi duhet të ofrojë mundësi njoftimi me email-e të të gjithë përdoruesave të përfshirë në një çështje apo menaxherë të organizatës në nivele të ndryshme.
- Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e regjistrimit të të gjitha aktiviteteve që ndodhin në çështje në formë “Logs” të ndara në kategori të ndryshme për të gjitha veprimet që do të kryhen në sistem.

---

### **Sherbimi i migrimit te moduleve Financiare ne ERP Cloud**

---

#### **6.1 DETYRAT SPECIFIKE**

Në kuadër të qëllimit kryesor të këtij projekti per perditësimin dhe kalimin ne versionin cloud te sistemit te administrimit financiar dhe logjistikes, projekti do te kaloje ne fazat e meposhtme:

- Faza I: Vleresimi i perdorimit aktual te Oracle E-Business Suite.

Ne kete faze, operatori ekonomik duhet te mbledhe informacion mbi mjedisin aktual te aplikimit, duke perfshire vecorite, funksionalitetet, pershtatjet dhe volumin e transakcioneve. Ne kete menyre vleresohet gatishmeria e aplikimit per te levizur ne Cloud.

- Faza II: Vendosja ne korrespondence e mjedisit aktual me Oracle Cloud.

Ne kete faze, operatori ekonomik duhet te fokusohet ne infrastrukturen aktuale si dhe ne cdo ngarkese jo Oracle. Duhet te percaktohet arkitektura e ardhshme Cloud, ne menyre qe te kuptohet se cilat vecori te mjedisit aktual mund te kalojne direkt ne cloud dhe cilat jo, ne menyre qe te adresohen keto te fundit. Ne kete faze duhet te merren parasysh dhe integrimet me sisteme te paleve te treta.

- Faza III: Lehtesimi i pershtatjes se perdoruesve.

Ne kete faze, operatori ekonomik duhet te percaktoje ne menyre te detajuar hapat qe do te ndiqen, kohen dhe sekuencen e detajuar te aktiviteteve. Gjithashtu, pertej elementeve teknologjik, duhet te adresohet ndikimi i perdoruesve nga migrimi ne cloud. Operatori ekonomik duhet te realizoje trajnimin e perdoruesve, te pergatise materialet udhezuese, dhe mbi te gjitha te fokusohet ne pershtatjen e biznesit me sistemin e ri, per te lehtesuar kalimin. Gjithashtu ne kete faze realizohet marrja ne dorezim dhe raportimi tek menaxheret e projektit.

#### **6.2. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT**

Zbatimi i procesit te upgrade te sistemit financiar ne platformen Cloud, duhet te kaloj ne hapat e meposhtem:

| Nr. | Emertimi i fazes / Periudha kohore                             | M1 | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 |
|-----|--|----|----|----|----|----|----|
| 1   | Faza Përgatitore për upgrade                                   | X  |    |    |    |    |    |
| 2   | Faza e zhvillimit të perditesimit, dhe pranimi i konfigurimeve |    | X  | X  | X  | X  |    |
| 3   | Trajnimi i perdoruesve   |    |    |    | X  | X  |    |
| 4   | Migrimi i te dhenave te hapjes se sistemit                     |    |    |    |    | X  |    |
| 5   | Perdorimi i sistemit ne paralel                                |    |    |    |    | X  |    |
| 6   | Fillimi i perdorimit te sistemit                               |    |    |    |    | X  | X  |

### 6.3. Testimi i sistemit

Plani i testimit duhet të përmbajë skenare të detajuar testimi, si edhe të përcaktojë testuesit, aktivitetin e testimit, kriteret e pranimit dhe marrjes në dorëzim. Plani i testimit duhet të nisi dhe të zhvillohet paralelisht me implementimin e moduleve të ndryshëm në cloud.

### 6.4. Përdorimi i sistemit në paralel

Gjatë realizimit të migrimit në cloud të moduleve, do të jete dhe një periudhë gjatë të ciles përdoruesit do të përdorin në paralel sistemin ekzistues on premise si dhe modulet e reja në cloud. Kjo fazë duhet të zgjase minimalisht 1 muaj, dhe do të shërbejë për të verifikuar kalimin e plotë të çdo funksionaliteti në cloud si dhe për të testuar saktësinë e konfigurimeve në cloud.

### 6.5. Migrimi i të dhënave

Për secilin modul në cloud do të jete e nevojshme të migrohen të dhënat e celjes duke u nisur nga të dhënat e sistemit aktual on premise. Operatori ekonomik, së bashku me stafin që ndjek projektin, do të përcaktojë datën e celjes së sistemit on cloud dhe do të bëjnë të mundur migrimin e të dhënave në cloud.

### 6.6. Trajnim stafi

Operatori ekonomik ka për detyrë të identifikojë nevojat për trajnim dhe të mundësojë materialet e nevojshme për trajnimin e përdoruesve. Ai duhet të organizojë trajnimet për stafin menaxherial dhe përdorues të sistemit si dhe për administratorët e sistemit. Në fund duhet të dorëzohen të gjitha materialet e trajnimit.

### 6.7. Supporti për gjatë periudhës fillestare të sistemit

Gjatë periudhës fillestare të përdorimit të sistemit në cloud duhet të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për përdoruesit e sistemit. Kalimi i përdoruesve në cloud do të jete gradual, paraprire kjo dhe nga përdorimi i sistemeve në paralel.

### 6.8 KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

---

Sistemet do të ruajnë ndërveprimet aktuale, por nëse do të ketë nevojë për ndërveprime të tjera pas zhvillimeve të kërkuara, operatori ekonomik fitues duhet t'i realizojë brenda kësaj procedure. Në menyre te vecante, sistemi duhet te komunikojë me sistemet:

- Email per njoftime te ndryshme qe lidhen me sistemin;
- Fiskalizimin Online, i cili kerkohet te kryhen ne kohe reale.

## 6.9 RAPORTIMI

*Kerkesat e Raportimin.* Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në original dhe në 2 (dy) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumit 12 faqesh duhet të prodhohet brenda 1 (një) muaji nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet te perbehet prej 20 (njëzet) faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit final është 5 (pesë) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi Sistemin . Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Raporti i përmendur mësipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

---

## TE DREJTAT E KODIT TE APLIKACIONIT

---

Cdo e drejtë mbi kodin burim apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me përmirësimet e zhvilluara në kuadër të kësaj kontrate, duhet t'i kalojë Autoritetit Kontraktor/përfituesit në format elektronik dhe në letër.

---

## Sherbimet e kerkuara te supportit si dhe percaktimet SLA

---

### 8.1 Nivelet e Shërbimit dhe Procesi

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë, për të gjitha sistemet e perfshira ne kontrate.

#### **Suporti i Nivelit të Parë**

- (a) **Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.**

---

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha sistemet e listuara në tabelen e Inventarit të Sistemit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë OST ose nepemjet lidhjes së dedikuar VPN, përveç rasteve kur OST përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

#### **(b) Shërbime Riparimi në vendndodhje.**

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor të operimit të OST, në kohezgjatjen 24x7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “ Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i OST ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin “Alarm Madhor” do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OST dhe të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

(i) ***Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.*** OST do të njoftojë Kompaninë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje Web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga Kompania me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Kompania duhet të kontaktojë OST-në dhe të konfirmojë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i APP-së. Në momentin e njohjes së thirrjes nga Kompania, OST do të vërë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga Kompania, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. OST do të koeporojë me kërkesën e Kompanisë për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

(ii) ***Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.*** Nëse kompania nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë OST-së brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga OST dhe do ti jepet akses në mjediset dhe sistemet e mbuluara pa çenuar sigurinë e të dhënave, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

(iii) ***Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.*** Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”, (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Kompania të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Kompania arrin në konkluzion që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit ose marrjen e rekomandimeve nga Suporti i Nivelit të Dytë.

#### **Suporti i Nivelit të Dytë**

Në rast se kompania nuk arrin dot të zgjidhë Alarmin Madhor dhe pas Veprimtarive të përshkuara më lart, atëherë ajo duhet të eskalojë problemin tek prodhuesit e komponenteve të sistemit



- 
- a. Oracle;
  - b. Newgen;

Teknikët e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trainuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesit dhe të mundesojnë zgjidhjen e çdo problemi në afatet kohore minimale. Kompania duhet të ketë punonjës të certifikuar në përputhje me kërkesat specifike të paraqitura me poshtë në këto dokument **per secilen nga teknologjite e mesiperme.**

Ata duhet të hapin ceshtjet tek këta prodhues, përshkruajnë problemin teknik që ka shkaktuar alarmin madhor, konsultohen së bashku për të gjetur zgjidhjen e problemit, marrë prej prodhuesve planin e veprimeve dhe rekomandimet për zgjidhje si dhe zbatimin e masave me përpikmëri sipas këtyre rekomandimeve.

Kompania do të paraqesë në ofertë autorizimet e prodhuesve Oracle; Newgen për të demonstruar se ka mbuluar me saktësi të gjithë komponentet e sistemit me support të Nivelit të Dytë. Të gjitha këto produkte duhet të kenë jetëgjatësinë sipas përcaktimeve në këto dokument.

## 8.2 Specifikimet teknike për shërbimin e Mirembajtjes të Sistemeve

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirembajtjen e sistemit të sistemeve Financiare, Arkives, Burimeve Logjistike dhe Burimeve Njerezore janë si më poshtë:

1. Monitorim periodik dhe të rregullt të roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit. Kompania duhet të ndermarre veprime proaktive dhe raportuese në rast të:
  - a. Ezaurimit të resurseve hardware
  - b. Mos funksionimit të shërbimeve të instaluar në rolet përkatëse
  - c. Rritjes së madhësisë së logeve në masën që ndikojnë në performancën e sistemit
  - d. Performancës dhe disponueshmërisë së ulët të sistemit
2. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastruktures.
3. Kompania duhet të garantojë support në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm ndikon në sistem.
4. Nderhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t'u aprovuar. Kompania duhet të bejë nderhyrjet në kohën përcaktuar.
5. Kompania duhet të kryejë kontroll periodik javor preventivues, monitorues në vendndodhjen e klientit ose me hyrje "remote të sigurt nepermjet VPN".
6. Kompania duhet të ofrojë suport lokal 24x7 (për probleme kritike, dhe gjatë orarit zyrtar për probleme të tjera) për sistemeve Financiare, Arkives, Burimeve Logjistike dhe Burimeve Njerezore duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të kontratës.
7. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollet e detyrueshme parandaluese dhe preventivuese, si edhe të përshkruajë dinamikën dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.

## 8.3 Shërbimet e Përmirësimit apo Modifikimit të Moduleve

---

Kompania fituese duhet te kryeje permiresime apo modifikime softwari qe perfshin, por nuk kufizohet vetem ne:

1. Azhornimin, permiresimin dhe modifikimin e sistemeve ekzistuese;
2. Pastrimin dhe konvertimin e te dhenave;
3. Permiresimi i performances se proceseve aktuale te sistemeve te perfshira ne kete kontrate;
4. Permiresimi i raporteve aktuale qe prodhohen nga sistemet e perfshira ne kete kontrate sipas kerkesave te institucionit.

Azhornimi, Permiresimi apo modifikimi i sistemit do te behet per modulet dhe versionet ekzistuese te pershkruara si komponente te sistemit. Modifikimet mund te lindin si pasoje e ndryshimeve ligjore ose kerkesave per permiresime nga perdoruesit etj.

Eshte i domosdoshem dokumentimi para dhe pas nderhytjeve te sistemeve Financiare, Arkives, Burimeve Logjistike, Burimeve Njerezore dhe sistemit te Menaxhimit te Dokumenteve te OST sh.a.

#### 8.4 Sherbime periodike dhe monitorimi i sherbimeve

Kompania duhet te krijojë / diskutojë me OST nje axhende periodike kontrollesh si me poshte:

1. Ditore
  - a. Monitorimi i statusit te sherbimeve nepermjet agjenteve (software monitorimi)
  - b. Ndermarrje e aksioneve specifike ne rast problemesh te verejtura.
  - c. Te kryeje mirembajtje proaktive.
2. Javore
  - a. Kontroll i logeve te serverave
  - b. Kontroll i disqeve per problem ne rast nevojë
  - c. Perditesim i aplikacioneve te serverave OS, etj.
  - d. Te kryeje mirembajtje proaktive.
3. Mujore.
  - a. Testim / kontroll i kompletuar i pjeseve me kritike te infrastruktures se klientit
  - b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve software
  - c. Rishikim i te dhenave mbi performance e serverave
  - d. Rekomandime per upgrade te mundshme hardware
4. Pergatitja e raporteve mujore dhe tre mujore mbi problemet, statusin dhe ecurine e zgjidhjes se tyre, per sherbimet e perfshira ne kete kontrate.

#### 8.5 Sherbime te konsulences

Pergjate sherbimit te mirembajtjes, Kompania duhet te ofrojë gjithashtu sherbimet e meposhtme te konsulences.

1. Asistence per stafin teknik te OST ne analizen e te dhenave, procedurat e backup-it, dhe raportimin e performaces.
2. Asistence teknike per problemet e lidhura me komunikimin me sisteme apo komponente te Infrastruktures.
3. Asistence per implementimin e certifikatave apo elementeve te tjere te sigurise.

4. Asistence per stafin teknik ne lidhjen e sistemeve te tjera te OST sh.a. me sistemet apo komponente qe permban kjo kontrate.
5. Dokumentimi i vleresimit te nevojave, kerkesave te perdoruesit dhe pergatitja e draftit te specifikimeve teknike per ndryshimet qe jane pasoje e ndryshimeve ligjore dhe qe prekin sherbimet elektronike te perfshira ne kete kontrate.
6. Asistenca ne pergatitjen e prezantimeve per sistemet te perfshira ne kete kontrate.

#### 8.6 Trajnimi i personelit teknik:

Kompania fituese duhet te ofroj ne vazhdimesi, sherbime te trajnimit qe lidhen me ndryshimet teknologjite te realizuara ne sistem apo me ndryshime ne strukturen organizative te personelit te OST. Keto trajnime duhet te planifikohen te realizohen si trajnime formale me material te vecanta trajnimi ne forme leter dhe elektronike te pergatitura per kete qellim; konfigurimin e kompjutera qe do te sherbejne per demonstrimin si dhe me nje proces formal te vleresimit te rezultateve pas trajnimit. Per nevojen e pergatitjes se ofertes teknike financiare, kompania duhet te paraqese se bashku me oferten teknike metodologjine e zhvillimit dhe te ndjekjes se trajnimeve ndersa volumi i pergjithshem i trajnimeve te planifikuara duhet te jene jo me pak se 4 kurse (2-3 ditore) me pjesemarres sipas nevojese drejtorive, per cdo vit.

Oferta duhet te permbaje planin e trajnimit per secilin nga modulet software te sistemit.

#### 8.7 Asistence ne vend per ceshtjet operacionale te sistemit Financiar

Pergjate sherbimit te mirembajtjes, Kompania duhet te ofroje nje konsulent te dedikuar per sistemin e administrimit Financiar. Konsulenti, duhet te jete i certifikuar nga prodhuesi Oracle i sistemit te administrimit Financiar dhe duhet te:

- sherbeje si pike e pare kontakti per personelin e Finances se OST. Asistenca kerkohet te ofrohet, jo vetem per ceshtje qe lidhjen me mos operimin apo difektet ne sistem, por kryesisht me problem apo asistence ne operimin e sistemit
- mbaj log per asistencen e dhene;
- pershkallezoje brenda personelit tjeter te konsulentit, ceshtje qe lidhen me mos funksionimin e rregullt te sistemit; dhe ndjek ne vazhdimesi zgjidhjen ne kohe te problematikave teknike;
- raportoje ne baze mujore listen e problematikave kryesore te hasura pergjate sherbimit te asistences teknike;

Sherbimi i asistences duhet te realizohen nga nje personel i dedikuar per minimalisht 30% te kohes

#### 8.8 Pergjigja si dhe pershkallezimi i sherbimit

Ne tabelen e meposhte percaktohet kategorizimi i seriozitetit te problemeve dhe koha e pergjigjes per zgjidhjen e tyre. Sigurimi i disponibilitet te sistemeve Financiare, Arkives, Burimeve Logjistike dhe Burimeve Njerezore duhet te jete 99%.

| Serioziteti 1 ( Kritik/ i Larte)  | Serioziteti 2 (I Mesem)   | Serioziteti 3 (I Ulet)  |
|---|---|---|
| <b>Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare</b>                               |   |   |
| Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime financiare te medha</i> per perdoruesit ose | Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime financiare te konsiderushme</i> per perdoruesit | Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime financiare minimale</i> per perdoruesit ose |

|   |  |  |
|---|--|--|
| <i>rrezikon shume aktivitetin ekonomik te perdoruesve</i>   | <i>ose rrezikon konsiderueshem aktivitetin ekonomik te perdoruesve</i>   | <i>rrezikon ne menyre minimal aktivitetin ekonomik te perdoruesve</i>  |
| <b>Pezullimi i punes</b>  |  |  |
| <i>Mos funksionimi i aplikacionit pengon perdoruesit te realizojne pjesen me te madhe te punes se tyre.</i>   | <i>Mos funksionimi i aplikacionit pengon perdoruesit te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre, por ata jane ne gjendje te realizojne pjesen tjeter. Mund te perfshije gjithashtu pyetje dhe pergjigje per informacion.</i> | <i>Mos funksionimi i aplikacionit pengon perdoruesit te realizojne nj pjese te vogel te punes se tyre, por ata jane ne gjendje te realizojne pjesen tjeter</i> |
| <b>Numri i perdoruesve te ndikuar</b>   |  |  |
| <i>Mos funksionimi i aplikacionit ndikon nje numer shume te madh te perdoruesve</i>   | <i>Mos funksionimi i aplikacionit ndikon nje numer shume te vogel te perdoruesve</i>   | <i>Mos funksionimi i aplikacionit ndikon ne 1 (nje) ose 2 (dy) perdorues</i>   |
| <b>Zgjidhje alternative e perkohshme</b> [Kjo ka peshen me te madhe te karakteristikave te Seriozitetit 1 dhe 2]  |  |  |
| <i>Nuk ka nje menyre alternative te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund te realizohet ne nje menyre tjeter)</i> | <i>Mund te kete ose jo nje menyre alternative te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.</i>   | <i>Potencialisht ekziston nje menyre alternative e perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.</i>   |
| <b>Koha e pergjigjes</b>  |  |  |
| <i>Brenda 30 minutave<br/>Paraqitja ne vend, jo me shume se 2 ore.</i>  | <i>Brenda 6 (gjashte) oreve ose ditën tjeter te punes.</i>   | <i>Brenda 24 (njetekater) oreve ose ditën tjeter te punes.</i>   |
| <b>Koha e Operimit te Supportit</b>   |  |  |
| <i>24 ore pergjate 7 diteve te javes</i>  | <i>Gjate orarit zyrtar</i>   | <i>Gjate orarit zyrtar</i>   |

## MJEDISI I TESTIMIT

Kompania, në kuader të kontrolleve periodike, duhet të paraqesë akt plan të detajuar të testimeve që do të kryhen dhe të vleresojë saktësisht funksionimin e sistemit dhe të nxjerë nevojat urgjente që duhen për të mbajtur sistemin në punë. Kompania duhet të krijojë / konfigurojë mjedisin e testimit për aplikimin e updateve, fikseve apo përditësimeve në Software, përpara instalimit të tyre në serverat production.

Kompania duhet të monitorojë çdo update që del nga prodhuesi i Software në internet dhe të propozojë pranë OST-së përparësitë e implementimeve të tyre. Ajo duhet te kryejë këto përditësime pasi të jetë rënë dakort dhe pas testimit të mundshëm.

**Shenim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

---

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

##### **2.2.1** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 20,000,000 (njezet milion) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

##### **2.3.1** *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 9,000,000 (nente milion) Lekë pa TVSH.*

*Lidhur me kete pike:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

---

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara) te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

- ISO 9001: Per menaxhimin e cilesise, qe ka lidhje me objektin e kontrates;
- ISO 27001: Per menaxhimin e sigurise se informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit te autorizuar per objektin e prokurimit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete certifikimet si me poshte:

- sisteme Oracle ERP;
- sisteme BI;
- infrastructure Cloud;
- sisteme ERP Cloud;
- sisteme per rrjetin e shpendarjes (Supply Chain);
- Certifikata e leshuar nga Tatimet dhe AKSHI si prodhues dhe per mirembajtjen e softuerike per fiskalizimin me dhe pa para ne dore, faturen elektronike si dhe faturen shoqeruese (qe ofertohej).

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij specialist te certifikuar per sistemet e meposhtme si vijon:

- 1 (nje) punonjes te certifikuar per zbatimet sistemesh Oracle Business Suite
- 1 (nje) punonjes te certifikuar per raportim BI
- 1 (nje) punonjes te certifikuar per sisteme cloud

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Operatori Ekonomik ofertues mund te disponoje punonjesit e mesiperme ne dy menyra:

- i. Ne stafin e tij dhe per kete duhet te kete certifikimet e punonjesve, listepagesen e fundit e-sig dhe kontratat e punes.
- ii. Me ane te kontraktimit dhe per kete duhet te kete kontraten noteriale dhe certifikimet paktese.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

**Shenim:**

- i. *Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*
- ii. *Ne plotesimin e “Formularit përmbledhës të vetedeklarimit”, OE ofertues duhet të shenojë në mënyrë të sakte, si prova paraprake: certifikimet e punonjësve, që disponon për plotesimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit. Këto deklaramë do të shqyrtohen kur OE ofertues do të paraqesë dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara për punonjësit, pas shpalljes fitues së ofertës. Keqinformimi dhe deklarimi i rreme me qëllim kualifikimin e ofertës, në mënyrë të padrejte, sanksionohet nga pika 1/a, të nenit 78 “Përfshirja për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*



## Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi   | Përgjigjja |
|--|------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | -----      |
| Numri NIPT/et:   | -----      |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar  | -----      |
| Përfaqësuesi (emri):   | -----      |
| Telefoni:  | -----      |
| E-mail:  | -----      |

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|---|
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| <b>Emri (at) e subjekteve</b> | <b>NIPT-i</b> | <b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b> | <b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b> |
|-------------------------------|---------------|---|---|
|                               |               |   |   |
|                               |               |   |   |
|                               |               |   |   |

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| <b>Deklarata</b>  | <b>Referencat (kur janë të zbatueshme)</b>  |
|---|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.                                | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose   | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  |

|   |  |
|---|--|
| <p>mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> | <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>   |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>  | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>  | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>   | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në</p>   | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |

|  |   |
|--|---|
| territorin e Republikës së Shqipërisë.   |   |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.  | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

| Deklarata   | Përgjigje |
|---|-----------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt: | _____     |
| 1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;  | Po [ ]    |
| 2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;  | Po [ ]    |

|   |                             |
|---|-----------------------------|
| <p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>  | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>  | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.</p> | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>   | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
| <p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>   | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
| <p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:</p>   | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |

|  |                             |
|--|-----------------------------|
| <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>   |                             |
| <p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>                         | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
| <p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p> | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
|  |                             |

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

| Deklarata  |
|--|
| <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe</li> </ul> |

Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

| Deklarata   | Përgjigje     |
|---|---------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:   |               |
| 1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.  | Po [ ] Jo [ ] |
| 2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga   | Po [ ] Jo [ ] |

|   |  |
|---|--|
| Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. |  |
|   |  |

### Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

| Deklarata   | Përgjigje     |
|---|---------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |
|   |               |

#### B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

| Deklarata  | Përgjigje   |
|--|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | <u>Punonjës</u><br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>_____<br><br>Profili i punonjësve<br><br>_____<br><br><u>Makineri e mjete</u><br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:<br><br>_____ |



---

|                                      |            |
|--------------------------------------|------------|
|                                      |            |
| Data e dorëzimit të deklaratës _____ | Vula _____ |
| Emri, Mbiemri, Firma _____           |            |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

*Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

---

**Shtojca 10**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**Formulari i Njoftimit të Skualifikimit 2**

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve në Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

---

<sup>2</sup>Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

---

## Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t

Vlera

\_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera

\_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet e mëposhtme

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet e mëposhtme

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej \_\_\_\_\_ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]**

## Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3

*(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)*

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë      Numri i NIPT-t      Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë      Numri i NIPT-it      Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë      Numri i NIPT-it      arsyet

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë      Numri i NIPT-it      arsyet

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

<sup>3</sup> Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

---

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]**

---

## Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

---

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme )

\_\_\_\_\_  
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme )

\_\_\_\_\_  
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Etj. \_\_\_\_\_

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**[Drejtuesi i Autoritetit /Entit Kontraktor]**



---

## Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT<sup>4</sup>)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_  
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_  
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

---

<sup>4</sup> Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

---

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *Numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_ *arsyet* \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *Numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_ *arsyet* \_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *Numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *Numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Etj. \_\_\_\_\_

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek [emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor ] sigurimin e kontratës brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr dhe datë) \_\_\_\_\_

**[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]**

---

### Seksioni III Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 16: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 17: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 18: Draftmarrëveshje ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 19: Draftmarrëveshje ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

## Shtojca 15

# Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

## Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

### 1.1 Përkufizimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

#### 1.1.1 Kontrata

**1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

**1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

**1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

**1.1.1.7** "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**1.1.1.8** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

**1.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

**1.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

**1.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

---

## **1.1.2 Palët e Kontratës**

**1.1.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruarit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

**1.1.2.2** "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimin Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

## **1.1.3 Llogaritja e afateve**

**1.1.3.1** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

## **1.1.4 Shërbimet**

**1.1.4.1** "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

## **1.1.5 Përkufizime të tjera**

**1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".

**1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".

**1.1.5.4** "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**1.1.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

**1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

**1.1.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

